VENDIM
Nr. 236, datë 2.5.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 149, DATË 29.2.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1, përmendur në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit nr. 149, datë 22.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numërtim dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë në datën 1 maj 2018 dhe përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2018 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERITAR

Funksioni	**Kategoria Klasa**	**Paga e grupit (lekë)**	**Shtesa për vjetërsi (%)**	**Shtesa për kushte pune (lekë) bëhet**
1	**2**	**3**	**4**	**6**
Titullar institucioni	I-b	1	2%	
Drejtor drejtorie	III-a	1	2%	
Shef sektori	III-a/1	1	2%	
Specialist auditi, specialist në Kryeministri; specialist/redaktor ligjor në Kryeministri	III-b	1 ose 2 ose3	2%	
Sekretar (i titullarit dhe i Bordit Drejtues)	IV-b	1 ose 2 ose3	2%	7000
Specialist kontabilist; specialist i burimeve njerëzore; specialist jurist; specialist prokurimesh; përgjegjës mirëmbajtje godina, përgjegjës sektori i pastrimit, përgjegjës i sektorit të ambienteve të jashtme; specialist koncep – desing, specialist logjistike, specialist shërbimi; përgjegjës i Qendrës së Transportit.	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	
Specialist; specialist finance, specialist buxheti; specialist kosto; specialist protokoll/arkivi; specialist IT, specialist mersolog, specialist trajtimi; specialist gjelbërimi, specialist inxhinier, sekretar për ish-presidentët.	IV-b	1 ose 2 ose3	2%	
Kryekuzhinier	X		1%	43500
Administrues vilash / qendrash	X		1%	12700
Kryepastiçier;	X		1%	17800
Magazinier i magazinës qendrore; Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare; Banakier;	IX		1%	
Kryekamerier	IX		1%	17800
Ndihmëspastiçier	IX		1%	12700
Shofer/korrier; magazinier (magazinë dytësore); teknik të ndryshëm; punëtor në rezidenca qeveritare; kamerier	VIII		1%	
Teknik elektricist/hidraulik/mirëmbajtje/kameraman/fotograf/operator shumëfishimi në Kryeministri	VIII		1%	7300
Kuzhinier Rezidenca e Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VIII		1%	17800
Kuzhinier Vila 31;	VIII		1%	12700
Ndihmësmagazinier; ndihmëskuzhinier, shofer; teknik dispeçer	VII		1%	
Shofer titullari në Kryeministri	VII		1%	17800
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor pastrimi, punëtor lavanderie; punëtor gjelbërimi; roje; lavazhier	V		1%	
Punëtor pastrimi në Kryeministri, recepsionist	V		1%	7300